

**Raport i intervistave telefonike
me studentët e Roma Versitas
Kosovo rreth gjendjes aktuale
me virusin Corona COVID-19**

Roma Versitas Kosovo

Prill 2020

Mirjeta Qehaja

ROMA
VERSITAS
KOSOVO

Rreth Roma Versitas Kosova

Roma Versitas Kosova është e vetmja organizatë që kryesisht punon me studentë romë, ashkali dhe egjiptianë në të gjithë Kosovën. Puna e këtij projekti është duke vazhduar për më shumë se shtatë vite, në mbështetje të 600 studentëve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në tre qendra mësimore të Kosovës, si ajo e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës.

Qëllimi kryesor ishte, dhe do të vazhdojë të jetë ngritja e performancës dhe aftësive në zhvillimin akademik dhe profesional të këtyre tre komuniteteve. Ne besojmë fuqishëm se shumica e studentëve do të jenë kontribues të shkëlqyer të Kosovës dhe të ardhmes së komuniteteve të tyre.

Vizjoni

Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm për komunitetet në Kosovë për integrimin dhe përfshirjen e komuniteteve përmes promovimit të arsimit; mbështetjes dhe zhvillimit akademik; trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve; dhe përfshirjes së të rinjve dhe komuniteteve në proceset e integritit lokal, në nivelin rajonal dhe evropian.

Misioni

Roma Versitas Kosova synon të përmirësojë mbajtjen, performancën dhe diplomimin në kohë, të studentëve romë në nivelin terciar të rregullt në Kosovë duke siguruar mbështetje akademike dhe ndërtim të kapaciteteve.

Hyrje

Ashtu si në të gjithë botën, edhe në Kosovë gjendja e virusit Corona ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në ndryshimin e rutinës së jetesës së njerëzve, ku të gjithë janë të izoluar në shtëpi dhe të mbyllur në qytete të karantinuara. Gjendja në Kosovë cdo ditë bëhet edhe më e vështirë përshkak të këtij virusi. E ata të cilët janë më të rrezikuar në këtë kohë janë komunitetet Rom, Ashaki dhe Egjiptian. Në bazë të statistikave, rreth 60% e këtyre komuniteteve janë të papunësuar dhe periudha e karantinimit është shumë e vështirë, sidomos për njerëzit të cilët i kanë kushtet e vështira socio-ekonomike.

Pasiqë virusi Corona është virus i ri, njerëzit nuk kanë shumë informacione dhe rrjedhimisht nuk dinë si të mbrohen. Pakujdesia dhe mos-informimi mund të ju kushtoj jetën. Për t'u siguruar që studentët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë të informuar mjaftueshëm dhe të siguruar me masa mbrojtëse në këtë kohë, TER-KOS program ka realizuar disa intervista. Studentëve i'u janë parashtruar pyetje rreth transmetimit të virusit, simptomave, masave parandaluese, gjendjes së tyre momentale socio-ekonomike dhe gjendjes së komunitetit në përgjithësi.

PROCESI I INTERVISTIMIT

Brenda 2 javëve intervistave i'u nënshtruan 86 studentë (70 përfitues të RVK dhe TER-KOS program, dhe 16 ish-studentë të RVK)

1. Numri i studentëve të intervistuar në bazë të qyteteve		2. Gjinija	3. Numri i studentëve të intervistuar në bazë të programit
1	Rahovec	46 F	63 studentë të RVK-së
2	Shtime	40 M	16 ish-studentë të RVK-së
2	Vushtri		7 studentë të TER-KOS program
2	Istog		
3	Fushë Kosovë		
3	Lipjan		
7	Prishtinë		
7	Ferizaj		
13	Gjakovë		
19	Pejë		
27	Prizren		


Intervistat u realizuan përmes thirrjeve telefonike. Prej 113 personave (studentëve dhe disa ish- studentëve të RVK) 27 prej tyre nuk i'u përgjigjen thirrjeve telefonike. Ndersa intervista me 87 studentë zgjati nga 15 min. Pas përfundimit të cdo interviste, studentëve i'u derguan mesazhe me informata rreth virusit Corona dhe masave parandaluese te virusit në mënyrë që të informohen më shumë dhe të mbrohen.

- **REZULTATET E INTERVISTAVE janë si në vijim:**

Më poshtë janë dhënë të gjitha pyetjet e intervistës sonë. Përgjigjet e pranuarra janë paraqitur grafikisht së bashku me një përshkrim të shkurtër.

1. A dini mjaftueshëm për VIRUSIN CORONA?

- PO- 81 persona
- JO- 0 persona
- Mesatarisht- 5 persona



Shumica e studentëve, pra 94% deklaruan se kishin njohuri të mjaftueshme rreth virusit Corona, kurse 6% Jo.


2. Si transmetohet tek njerëzit?

Shumca e të intervistuarve kanë pasur mesatarisht informata, se virusi transmetohet përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me persona të infektuar (coft përmes spërkalave, duarve/prekjes, tubimeve etj). Mirpo vetëm 2 prej tyre theksuan se edhe sipërfaqet e kontaminuara mund të jenë rrezik I transmetimit të virusit, ndersa vetem 4 prej tyre theksuan që virusi mund të bartet edhe nga gjësendet.

Duke u bazur në këtë, studentëve iu parashtrua edhe pyetja e drejtëpërdrejtë:

2.1 A mendoni që virusi mund të transmetohet edhe përmes gjësendeve që i bleni në shitore, dhe a duhet pasturar ato?


- PO- 23 pesona
- JO-5 pesona
- Ndoshta-5 pesona



Nga 33 studentë që i'u parashtrua kjo pyetje, 5 prej tyre (14%) nuk ishin në dijeni dhe 5 të tjerë (14%) nuk ishin të sigurtë.

3. A jeni në dijeni se cilat janë simptomat e para të virusit Corona?


- Po- 84 pesona
- Jo- 2 pesona




Vetëm 2 prej studentëve deklaruan se nuk kishin shumë njohuri, ndërsa shumica kanë pasur informata të mjaftueshme rreth simptomave të para të virusit (dhimbje fyti, temperatura, kolli i thatë, ethe, vështirësi në frymëmarrje, kokëdhembje, dhembje të gjoksit, lodhje të vazhdueshme, humbja e imunitetit dhe oreksit)

4. A e dini cilat janë masat parandaluese?

- Po- 86 persona
- Jo- 0 persona




4.1 Cilat janë ato?



Shumica kanë qenë të informuar mesatarisht rreth masave parandaluese të virusit Corona (higjena e pastër, qëndrimi në shtëpi, përdorimi i maskave dhe dorëzave, rrespektimi i distancës etj) Mirpo vetëm 4 prej tyre theksuan se përdorimi i vitamins C mund të ndikoj pozitivisht në parandalimin e virusit kurse (një prej tyre ka deklaruar se edhe përdorimi i limonit ndikon në parandalim, sepse ka vitamin C) Poashtu këta 4 studentë kanë shtuar se duhet bërë edhe dezinfektimi i shpesht i hapsirave ku jetojmë.


5. A jeni të furnizuar me ushqime të mjaftueshme dhe mjete higjienike?

- PO- 16 persona
- JO -70 persona



81% e studentëve deklaruan që nuk kishin ushqim të mjaftueshëm, dhe mjete higjienike, ku shihet një nevojë urgjente për ndihmë.

6. A e njihni ndonjë familje nga komuniteti që është në kushte shumë të këqija (pa ushqim) në këtë kohë dhe që nuk ka marr asnje ndihmë? Kush?



Nga 86 studentë të intervistuar 28 prej tyre kishin informata rreth familjeve që kanë nevojë për gjëra ushqimore dhe higjienike, kurse 58 prej tyre nuk kishin informata.

Nga intervistat e realizuara me studentët e Roma Veristas Kosovo, kemi marrë rreth 130 kontakte të familjeve në nevojë në të gjithë Kosovën nga komunitetet Rom Ashkali dhe Egjiptian në këto ditë të vështira të virusit Corona. Kontaktet do të shërbejnë për ndihma me pako ushqimore dhe higjienike.

1) REKOMANDIMET:

1. Për të gjithë rreth virusit Corona

- 1) Duhet të kemi më shumë kujdes nga cdo ambient dhe madje edhe ushqimet te cilat i blejmë në markete të ndryshme. Duhet pastruar cdo produkt që e sjellim nga amientet e jashtme në shtëpi.
- 2) Duart duhet pastruar cdo herë (minimum 20 seconda) e sidomos kur të kthehemi nga ambientet e jashtme.
- 3) Duhet të bëhet dezinfektimi i shpesht i ambienteve të cilave jetojmë.
- 4) Përdorimi i vitaminës C ndikon shumë në parandalim.
- 5) Përdorimi i maskave dhe dorëzave kur dalim jashtë shtëpisë janë të obligueshme.

Për më shumë ndicni këshillat e Institutit Të Shëndetit Publik:

<http://ëëë.ishp.gov.al/koronavirusi-pyetje-dhe-pergjigje/>

2. Për studentët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian:

-
- 1) Në bazë të intervistave 67% e studentëve nuk kanë pasur informata rreth familjeve në nevojë. Nga kjo del që shumica e studentëve nuk kanë informata/nuk e njohin mirë komunitetin që e përfaqësojnë. Pasi që ne e dimë që 60% e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë të papunë dhe e dimë gjendjen reale të komuniteteve, i rekomandojmë studentët që pasi të përmissohet situata e virusit Corona të bëhen më aktiv në avokim dhe lidhësi.

3. Për Institucionet:

- 1) Institucionet përkatëse duhet të punojnë më shumë me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në mënyrë që t'i informojnë ata më shumë rreth virusit Covid-19
- 2) Autoritetet lokale duhet të ofrojnë ndihmë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

PERFUNDIME:

- **Duke u bazuar në intervistat e TER-KOS u pa një nevojë urgjente për t'i ndihmuar studentët tanë, me gjëra ushqimore dhe higjienike në këto kohë të vështira. Andaj Roma Veristas Kosovo dhe TER-KOS program (të financuara nga REF) në bashkëpunim me GAIA dhe CRD- Roma Acted Program, do t'i ndihmojë studentët në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike.**
- **Me ndihmën e praktikantëve të TER-KOS program që i realizuan këto intervista ne poashtu fituam edhe 130 kontakte dhe informata të reja të familjeve Rom, Ashkallike dhe Egjiptiane në Kosovë të cilët kanë nevojë për ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike. Këto lista do t'i shqyrtojmë së bashku me donator tjerë dhe së shpejti do të ndihmohen familjet në nevojë.**

©Roma Versitas Kosovo

Mirjeta Qehaja
TER-KOS program
Prishtinë
2020

Project “EU Regional Action for Roma Education: Increased education opportunities for Roma students and Roma youth in Western Balkans and Turkey”



The project “EU Regional Action for Roma Education: Increased education opportunities for Roma students and Roma youth in Western Balkans and Turkey” is funded by European Union and implemented by the Roma Education Fund

Mbështetur nga:



ROMA
VERSITAS
KOSOVO

